DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracija
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-267/7
-V1- Data Datum Date 21.04.2021

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt<br>Kristina Gashi Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Ferizajt | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Kransiqi,** Ministër i MAPL-së<br><br>**Trim Berisha**, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 16/04 /2021<br>Nr. 020-267 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Driton Xhafa**, Zyrtar për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizajt | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë se Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimit nr. 35 për dhënien afatshkurtër të pjesës ngastrës kadastrale 570-1 dhe 569-1 zona kadastrale Ferizaj Shoqatës për Persona me Aftësi të Kufizuar - HENDIFER |
| I miratuar më datë: 25.03.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 29.03.2021 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës <u>**është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**</u>.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim |
|---|---|---|
| 1. | Vendimit nr. 35 për dhënien afatshkurtër të pjesës ngastrës kadastrale 570-1 dhe 569-1 zona kadastrale Ferizaj Shoqatës për Persona me Aftësi të Kufizuar - HENDIFER | Vendimit nr. 35 për dhënien afatshkurtër të pronës se komunës organizatës HENDIFER nuk përmban dy elemente kryesore *"Mos publikimi i pronës ne web faqen zyrtare të komunës"* si dhe *"Mos dokumentimin e zhvillimit të konkurrencë se OJQ-ve"* qe janë kritere të përcaktuara në Ligjin nr. 06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave te Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.<br><br>Ligji nr. 06/1-092 në nenin 13 pika 1 ka përcaktuar se *"Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës"*<br><br>Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 ka përcaktuar ne nenin 16 pikas 3 se *"Procedurat e konkurrimit bëhet vetëm për organizatat e shoqërisë civile të cilat veprojnë në territorin e komunës përkatëse"*.<br><br>Andaj bazuar në të lartcekurat dhënia në shfrytëzim të ngastrës 570-1 dhe 569-1 zona kadastrale Ferizaj është bërë pa publikuar listën e pronës si duke mos dokumentuar procesin e konkurrimit prandaj si e tillë përben shkelje të kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës. |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Ferizajt që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALIPSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-267/7
-VI- Data 21.04.2021

# Republika e Kosovës
# Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Agim Aliu, gradonačelnik opštine Uroševac<br>Kristina Gashi Bytyqi, predsedavjuća Skupštine opštine Uroševac | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u,<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini, | |
| Preko: | Elbert Krasniqi ministar MALS-a,<br>Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MALS-a, | |
| Od: | Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS | Dana, 16.04.2021.<br>Br: 020-267 |
| Odgovorni službenik: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština MLS | |
| Službenik-ca za izradu pravne procene: | Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Uroševac | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja utvrđenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premiera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 35 o davanju na kratkoročno korišćenje dela katastarske parcele br. 570-1 i br. 569-1 katastarska zona Uroševac, Udruženju za osobe sa invaliditetom – "HENDIFER" |
| Usvojena dana, 25.03.2021. |
| Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 29.03.2021. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

Neusaglašenosti opštinskog akta podnetog na razmatranje zakonitosti su kao u nastavku:

| **Br.** | **Formulisanje u aktu opštine** | **Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.** |
|---|---|---|
| | | |
| 1. | Odluka br. 35 o davanju na kratkoročno korišćenje dela katastarske parcele br. 570-1 i br. 569-1 katastarska zona Uroševac, Udruženju za osobe sa invaliditetom – "HENDIFER" | Odluka br. 35 o davanju na kratkoročno korišćenje dela katastarske parcele br. 570-1 i br. 569-1 katastarska zona Uroševac, Udruženju za osobe sa invaliditetom – "HENDIFER" ne sadrži dva ključna elementa *"neobjavljivanje imovine na službenoj web stranici opštine"* kao i *"nedokumentisanje razvoja o konkuretnosti NVO-a"* kriterijumi koji su utvrđeni u Zakonu br. 06/l-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine i Uredbu VRK-a br. 09/2020, o utvrđivanju postupaka za davanje na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine.<br><br>***Zakon br. 06 / l-092 u članu 13 tačka 1 odredio je da*** *„Opština mora da objavi opštu listu nepokretne imovine, kao i posebnu listu imovina koje se planiraju za davanje na korišćenje za tekuću godinu do 31. decembra, opravdavajući javni interes i ekonomski razvoj opštine "*<br><br>Uredba VRK br. 09/2020 u članu 16. tačka 3 odredila je da: *"Postupci konkurisanja se vrše samo za organizacije civilnog društva na teritoriji relevantne opštine"*<br><br>Stoga, na osnovu gore navdenih, davanje na korišćenje parcela br. 570-1 i br. 569-1 katastarska zona Uroševac urađena je bez dokumentiranja postupka konkurisanja i kao takva čini kršenje *zahteva za davanje na korišćenje opštinske imovine.* |

Iz gore navedenog, Ministarstvo ladministracije lokalne samouprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine **traži** da preduzmu konkretne delatnosti kako bi akt opštine uskladile sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za daljna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 29.03.2021
-VI- 020-267
Ferizaj - Uroševac
29.03.2021
01 35 02

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 35
Datë: 25.03.2021

Në bazë të nenit 12. paragrafit 12.2. pika d të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e nr. 28/15. qershor 2008) nenit 4. neni 17 të Ligjit nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. të nenit 17 të Rregullores QRK nr. 09/2020. për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës. të nenit 51. paragrafit 2. pika 2.9 te Statutit te Komunës së Ferizajt 01. Nr.50 të datës 28.6.2013 Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur me datën. **25.03.2021** miratoi:

**VENDIM**
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE 570-1 DHE 569-1 Z.K FERIZAJ. SHOQATËS PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA- HENDIFER**

**I**

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të komunës 01.Nr.49 i datës 25.03.2021 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pjesës së ngastrës kadastrale 570-1 me sipërfaqe 471 m$^2$ dhe 569-1 me sipërfaqe 729 m$^2$. shoqatës për persona me aftësi të kufizuara- Hendifer me nr identifikues 5101539-8 me adresë në rr. "Ramdan Rexhepi" pronë e komunës së Ferizajt.

**II**

Afati për dhënie në shfrytëzim të pjesës së parcelës të përshkruar në pikën I është 15 vite. me mundësi vazhdimi me vendim të ri të Kuvendit të Komunës

**III**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të parcelës të cekur në pikën I të këtij vendimi është përmbushja e interesit të përgjithshëm si :

Krijimi i të gjitha kushteve për ushtrimin e aktiviteteve humanitare dhe të atyre që janë paraparë të zhvillohen në të ardhmen. lehtësimi dhe përmisimi i kushteve shëndetësore dhe sociale për persona me aftësi të kufizuara. ndërtimi i një objekti të ri që ka për qëllim që të përmisojë dukshëm nevojat e anëtarëve si dhe do të ketë një qendër ditore . sallë për ushtrimin e aktiviteteve. trajnimeve të personave me aftësi të kufizuara. të ketë stafin juridik dhe shëndetësor si dhe pishinë për sportin e notit.

IV

Veprimtaria që mund të ushtrohet sipas destininimit të pronës; Prona mund të shfrytëzohet vetëm për ndërtimin e objektit pëe persona me nevoja të veçanta dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera pa vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës.

V

Prona e përshkruar në pikën I të ketij vendimi ipet Pa Kompenzim

VI

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Pronë. Gjeodezi dhe Kadastër.

VII

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale si dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

Kristina Gashi Bytyçi

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217092-00570-1

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | 34859-2021 |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 14.04.2021 - 11:57 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Ferizaj / Uroševac / Ferizaj |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-72217092-00570-1** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 474 | 697/2019, RFP.177/2019 | 11.10.2019 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| KODRA E KAZERMËS/KODRA E KAZERMËS KODRA E KAZERMËS | | KODRA E KAZERMËS | 11.10.2019 | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Shpresa.Ramadani | P-72217092-00570-1 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Rajon Ujor/Vodeni Region/Water | Lum/Reka/river | | 474 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **KUVENDI KOMUNAL FERIZAJ** | KCID2218512 | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ / | | | **1/1** | | 11.10.2019 |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217092-00569-1

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **34859-2021** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 14.04.2021 - 11:58 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Ferizaj / Uroševac / Ferizaj |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-72217092-00569-1** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | **4418** | 697/2019, RFP.177/2019 | 11.10.2019 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| KODRA E KAZERMËS/KODRA E KAZERMËS/KODRA E KAZERMËS | | KODRA E KAZERMËS | 11.10.2019 | |



Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 4388 |
| 2 | Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand | Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive | | 30 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **KUVENDI KOMUNAL FERIZAJ** | KCID2218512 | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ / | | | **1/1** | | 11.10.2019 |

**Driton Xhafa**

---

| | |
|---|---|
| **From:** | Driton Xhafa |
| **Sent:** | Wednesday, April 14, 2021 2:58 PM |
| **To:** | Sabri A. Murseli; Kristina Bytyqi |
| **Cc:** | Venera Çerkini |
| **Subject:** | RE: Plotësim i lëndëve nr. 31 dhe 35 |

Te nderuar përshëndetje edhe një here,

Vendimit nr. 35 për dhënien afatshkurtër të pjesës ngastrës kadastrale 570-1 dhe 569-1 zona kadastrale Ferizaj Shoqatës për Persona me Aftësi të Kufizuar – HENDIFER i mungon

- Kërkesën zyrtare te institucionit përkatës (HENDIFER) si dhe prona nuk është e publikuar ne web faqen zyrtare per dhënie ne shfrytëzim

këto dy kërkesa nëse nuk plotësohen nga komuna deri me datën 15.04.2021 akti do kthehet për rishqyrtim nga MAPL.

**From:** Sabri A. Murseli <sabri.a.murseli@rks-gov.net>
**Sent:** Wednesday, April 14, 2021 12:44 PM
**To:** Kristina Bytyqi <Kristina.Bytyqi@rks-gov.net>; Driton Xhafa <driton.xhafa@rks-gov.net>
**Cc:** Venera Çerkini <Venera.Cerkini@rks-gov.net>
**Subject:** Re: Plotësim i lëndëve nr. 31 dhe 35

Pershendetje i nderuar, uroj te jeni mire me shendet dhe punet ti keni mire po ashtu.

Po ju shkruaj lidhur me kerkesen tuaj per informata shtese lidhur me vendimet me numer 31 dhe 35.

Per sa i perket vendimit me numer 31 objekti eshte i publikuar ne listen e pronave komunale me numer rendor 50 ne te cilen kolone eshte regjistruar sebashku me numrin e parceles 1745-1-1-32 ndersa ne kadaster eshte i regjistruar vetem me numer te zones kadastrale dhe numer te objektit 32, po ashtu ju njoftojme se lidhur me kete objekt nuk ka asnje barre apo obligim te paleve te treta kjo deshmohet permes Çertifikates se pronesise.

Per sa i perket vendimit me numer 35, prona ne fjale nuk eshte e publikuar ne listen e vençant te pronave komunale per dhenie ne shfrytezim, ndersa nuk ka ndonje obligim ndaj paleve te treta.

Te bashkangjitura i gjeni Çertifikatat e pronesise per objektin me nr. 32 dhe parcelat 570-1 dhe 569-1, si dhe linkun per listen e vençant te pronave komunale per dhenie ne shfrytezim.

https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2020/12/Lista-e-Pronave-per-vitin-2021.pdf

---

**From:** Kristina Bytyqi
**Sent:** Wednesday, April 14, 2021 11:46 AM
**To:** Driton Xhafa

**Cc:** Sabri A. Murseli
**Subject:** Fw: Plotësim i lëndëve nr. 31 dhe 35

Pershendetje i nderuar,
Patjeter drejtori do i jep pergjigjjet ne kohen me te shkurter.

Me respekt!

---

**From:** Driton Xhafa
**Sent:** Wednesday, April 14, 2021 9:43 AM
**To:** Kristina Bytyqi
**Cc:** Zyliha Tafarshiku; Venera Çerkini; Gëzim Sahiti
**Subject:** Plotësim i lëndëve nr. 31 dhe 35

E nderuara znj. Bytyqi,

Në emër të Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL) ju përshëndesë dhe në të njëjtën kohë ju informojmë se jemi në procedurë të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të kuvendit të komunës se Ferizajt të datës 29.03.2021. Bazuar në RREGULLOREN (QRK) NR.10/2019 PËR SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TE AKTEVE TË KOMUNAVE nenin 9 pika 8 kërkon informata shtesë lidhur me dye (vendime). Fjala është për këto akte:

- Vendimit nr. 31 për dhënien afatshkurtër të pjesës se objektit me nr. 0-72217092-32-0 Qendrës Inovacionit me sipërfaqe 810$^{m2}$
- Vendimit nr. 35 për dhënien afatshkurtër të pjesës ngastrës kadastrale 570-1 dhe 569-1 zona kadastrale Ferizaj Shoqatës për Persona me Aftësi të Kufizuar – HENDIFER

Për vendimin nr. 31 kërkohet të dëshmohen se;

1. Nuk ka ndonjë obligim për palët e treta
2. Linkun e web faqes zyratre të komunës ku prona e parapare për dhënien ne shfrytëzim është e publikuar

Për vendimin nr. 35 kërkohet të dëshmohen se

3. Nuk ka ndonjë obligim për palët e treta
4. Fletat poseduese dhe
5. Linkun e web faqes zyratre të komunës ku prona e parapare për dhënien ne shfrytëzim është e publikuar

Deri ne dërgimin e informatave te lartcekura pezullohet shqyrtimi i ligjshmërisë se dy vendimeve. Informatat plotësuese e dërguar nga komuna e Ferizajt determinojnë shqyrtimin e ligjshmërisë. Për çdo informatë sqaruese jemi ne dispozicion e Juaj. Me te mira dhe suksese.